



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1878/5 prot.

Datë 10.08.2026

V E N D I M

Nr. 955/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukture hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukture hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK me NIPT: K72223007O dhe me adresë: *Njesia bashkiake nr 5, rruga Pjeter Bogdani, godina nr 3 , Tiranë.*

Operatori ekonomik “H O R I Z O N” SHPK me NIPT: K52225004V dhe me adresë: *Rruga Beqir Luga , Nd.8/1, H.7, Ap.2, 1017, Pazari i Ri, Njesia Administrative N.r 2, 101 Tirane.*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
Adresa: *Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “H O R I Z O N” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04-06-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukturës hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6798, datë 13.06.2026 dhe me nr. protokoli 1878/2026 datë 15.06.2026 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukturës hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 2335/8 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1886/1 prot datë 24.06.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin e ndërmjetëm nr. 100/2026, datë 19.06.2026 ka vendosur të ndërpresë afatin 5-ditor për marrjen e vendimit lidhur me ankesat e paraqitura deri në marrjen e informacionit të njevojshëm nga autoriteti kontraktor përfitues afat ky që nuk duhet të kaloj periudhën 30 ditore.

II.5. Me shkresën nr.2335/15 prot., datë 21.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1878/2 prot datë 23.07.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 132/2026 prot, datë 21.07.2026 ka vendosur pranimin e plotë të saj.

II.6. Në datën 15.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6807, dhe me nr. 1886/2026 prot, datë 15.06.2026, e operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukture hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.8. Me shkresën nr. 2335/8 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1886/1 prot datë 24.06.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin e ndërmjetëm nr. 100/2026, datë 19.06.2026 ka vendosur të ndërpresë afatin 5-ditor për marrjen e vendimit lidhur me ankesat e paraqitura deri në marrjen e informacionit të njevojshëm nga autoriteti kontraktor përfitues afat ky që nuk duhet të kaloj periudhën 30 ditore.

II.9. Me shkresën nr. 2339/13 prot., datë 21.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1886/2 prot., datë 23.07.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 131/2026 prot, datë 21.07.2025 ka vendosur pranimin pjesërisht të saj vetëm për pretendimin e mëposhtëm:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentet e tenderit, procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për këtë procedurë prokurimi, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues konstaton se kriteret për përzgjedhjen e ofertës fituese janë bazuar në raportin më të mirë çmim-cilësi, që do të vlerësohet bazuar në kualifikimin dhe kompetencat profesionale të stafit teknik, duke marrë në konsideratë eksperiencën në punë në vite si dhe eksperiencën në projekte të ngjashme në numër.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e tenderit janë formuluar duke përmbytur dy faza, së pari, fazën e përzgjedhjes ku përfshihen kriteret e veçanta të kualifikimit dhe në përfundim të saj përzgjidhen dhe kualifikohen Operatorët ekonomikë ofertat e të cilëve klasifikohen si të vlefshme dhe së dyti, faza e përzgjedhjes së Operatorit ekonomik, i cili do të shpallet fitues në varësi të raportit çmim-cilësi sipas kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese.

Në këtë kuadër, vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, si: Çmimi (60 pikë), Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik (40 pikë), sipas dokumentave të tenderit, të hartuara dhe publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në Dokumentet e Tenderit, Autoriteti Kontraktor, ka implementuar informacionin e nevojshëm në lidhje me kapacitetin teknik e konkretisht me stafin teknik ku dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, do të shërbejë që ofertat të kualifikohen, më pas për shpalljen e fituesit do të analizohen kualifikimet dhe kompetencat profesionale të stafit teknik.

Vlerësimi do të realizohet bazuar në eksperiencën në punë në vite si dhe në eksperiencën në numër lidhur me projektet e ngjashme të realizuara nga secili punonjës, sa më shumë eksperiencë në shtrirje kohore dhe sa më shumë projekte të ngjashme të realizuara aq më shumë pikë merr ofertuesi dhe kështu vazhdon në shkallë zbritëse.

KSHA gjykon se mbështetur në objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë me shërbimin e përmirësimit të infrastrukturës hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike, kriteret kualifikuese duhet të jenë në raport dhe në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës objekt prokurimi. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të provojnë dhe të dokumentojnë se kanë aftësitë e nevojshme profesionale në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi, pra në rastin konkret kanë detyrimin që të garantojnë realizimin e shërbimit, sipas kushteve të përcaktuara nga AK të implementuara në DT, si dhe në përputhje me Specifikimet Teknike të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimimi.

Duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë dhe kritike të shërbimit objekt prokurimi, i cili lidhet ngushtësisht dhe në mënyrë direkte me një projekt të integruar të transformimit të infrastrukturës së qendrës së të dhënave, i cili përfshin pesë blloqe të pandashme: projektim; furnizim; implementim; migrim dhe testim si dhe mirëmbajtje, ku dështimi në një bllok ndikon drejtpërdrejt tek të tjerët, kualifikimet dhe kompetencat profesionale të stafit teknik të Operatorëve ekonomikë pjesëmarrës përbën një element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të shërbimit. Në këtë kuadër, ky kriter për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë me oferta ekonomike-ligjore dhe teknike të vlefshme është i arsyeshëm, objektiv dhe i lidhur ngushtësisht dhe drejtpërsëdrejti me objektin e kontratës, duke siguruar realizimin me cilësi dhe në mënyrë të vazhdueshme të shërbimit të kërkuar.

Bazuar në këtë aspekt të vlerësimit teknik dhe përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë ka derivuar edhe përcaktimi i këtij kriteri, klasifikuar si kriter peshe/pikëzimi me një total prej 40 pikësh.

Në lidhje me pretendimin e OE ankimues: "...Rishikimin e metodologjisë dhe shpërndarjes së pikëve, me qëllim që vlerësimi teknik të mos mbështetet ekskluzivisht në kualifikimet dhe eksperiencat e stafit, por të përfshijë edhe elementë që lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë e zgjidhjes së së propozuar, arkitekturën teknike, metodologjinë e implementimit, sigurinë, performancën dhe siponueshmërinë e infrastrukturës që do të implementohet...", KSHA gjykon se: Në Dokumentet e Tenderit, Njoftimi Kontratës, Seksioni 4, pika 4.4, Autoriteti Kontraktor, ndër të tjera ka argumentuar se: "Vlerësimi në pike për kualifikimin profesional dhe përvojën e stafit është vendosur për të siguruar furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture hardware dhe rrjeti me nivel të lartë kompleksiteti. Projekti përfshin arkitekture 2-site me Stretched Cluster 16 servere blade, 2 storage FC, 4 SAN Sëitch, 4 firewall qendrore, 10 firewall degesh, sëitch datacenter dhe degesh, load balancer me WAF dhe platforme analize ngjarjesh sigurie. Përvoja profesionale e stafit përben një tregues të drejtpërdrejtë të cilësive të realizimit të kontratës, stabilitetit operacional dhe menaxhimit të riskut teknik gjatë fazave të implementimit dhe mirëmbajtjes 24- mujore...".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se metodologjia e vlerësimit të ofertave është ndërtuar mbi kriterin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në raportin çmim-cilësi, ku 60 pikë i atribuohen elementit ekonomik, konkretisht çmimit të ofertës, ndërsa 40 pikë elementit cilësor, të përfaqësuar nga kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik që do të angazhohet në realizimin e kontratës.

Gjithashtu nga një analizë e detajuar e Dokumenteve të Tenderit, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka ndarë komponentin cilësor prej 40 pikësh sipas profileve profesionale të stafit teknik të kërkuar për realizimin e kontratës, duke vlerësuar për secilin prej tyre eksperiencën profesionale në vite si dhe eksperiencën në projekte të ngjashme. Kjo metodologji synon të evidentojë Operatorin ekonomik që disponon personel me nivelin më të lartë të kualifikimit dhe përvojës profesionale, si një element që lidhet drejtpërdrejtë me cilësinë e ekzekutimit të kontratës.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 45, pika 7 parashikohet shprehimisht se: "7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit."

Nga sa më lart, KSHA vlerëson se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik i njeh Autoritetit Kontraktor diskrecionin në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të peshës së secilit kriter, për sa kohë që këto janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, janë objektive,

proporcionale dhe respektojnë parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive. Për rrjedhojë, përcaktimi i raportit 60% për çmimin dhe 40% për elementët cilësorë përbën shprehje të ushtrimit të këtij diskrecioni nga ana e AK.

Në rastin konkret, KSHA, konstaton se shpërndarja e pikëve është e lidhur ngushtë me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve teknike, kontrata nuk konsiston vetëm në furnizimin e pajisjeve hardware, por përfshin një projekt të integruar që përbëhet nga projektimi, instalimi, konfigurimi, implementimi, migrimi, testimi dhe mirëmbajtja e një infrastrukture kritike të teknologjisë së informacionit. Projekti përfshin, ndër të tjera, implementimin e një arkitekture me dy site (Stretched Cluster), serverë blade, sisteme enterprise storage, rrjet SAN, pajisje të avancuara të rrjetit, firewall, load balancer me funksionalitete WAF, platformë virtualizimi dhe mirëmbajtje shumëvjeçare të të gjithë infrastrukturës.

Në këto kushte, realizimi me sukses i kontratës nuk varet vetëm nga karakteristikat teknike të pajisjeve të ofertuara, por edhe nga aftësia profesionale e personelit që do të kryejë instalimin, konfigurimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Për rrjedhojë, vlerësimi me pikë i eksperiencës dhe kompetencave profesionale të stafit teknik përbën një kriter objektiv, proporcional dhe të lidhur drejtpërdrejtë me cilësinë e ekzekutimit të kontratës, duke synuar përzgjedhjen e Operatorit ekonomik që ofron garanci më të larta për realizimin e saj në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se Autoriteti Kontraktor ka ushtruar diskrecionin e tij brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik, duke argumentuar në mënyrë të mjaftueshme lidhjen ndërmjet metodologjisë së vlerësimit, shpërndarjes së pikëve dhe specifikimeve teknike të objektit të prokurimit. Për rrjedhojë, metodologjia e përzgjedhur rezulton të jetë e ligjshme, e arsyeshme dhe proporcionale me natyrën, kompleksitetin si dhe rëndësinë e kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu, parimi i ushtrimit të diskrecionit në vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor për përzgjedhjen e kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese, i nënshtrohet edhe rregullimeve të Nenit 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”, të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se :

“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) është i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;dhe;

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e ankimuesit se: “...Komisioni i Vlerësimit nuk disponon kritere të qarta dhe të verifikueshme për të matur në mënyrë objektive nivelin e kontributit teknik të ekspertit në secilin projekt, rëndësinë e projektit në raport me objektin e kësaj kontrate, apo shkallën e ngjashmërisë së tij me infrastrukturën që kërkohet të implementohet...”, KSHA gjykon se: Nga shqyrtimi i Dokumenteve të Tenderit, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që, për efekt të vlerësimit të eksperiencës së stafit teknik, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin CV- të e punonjësve, të cilat duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi eksperiencën profesionale, si dhe mbi projektet ose kontratat e ngjashme të realizuara, duke përfshirë objektin e kontratës, përshkrimin teknik të saj dhe të paktën një kontakt reference për secilin projekt ose kontratë.

KSHA vlerëson se CV-ja përbën një dokument deklarativ, i hartuar nga vetë personi ose Operatori ekonomik, i cili, megjithëse përmban informacion mbi kualifikimet dhe eksperiencën profesionale, nuk përbën në vetvete provë të mjaftueshme për të verifikuar në mënyrë objektive saktësinë e të dhënave të deklaruara, nivelin e angazhimit të ekspertit në projektet e referuara, natyrën e kontributit të tij, si dhe shkallën e ngjashmërisë së këtyre projekteve me objektin e kontratës.

Për sa kohë që eksperiencia profesionale e stafit teknik përbën element të pikëzueshëm dhe ndikon drejtpërdrejt në renditjen e ofertave, metodologjia e vlerësimit duhet të mbështetet në dokumentacion provues të mjaftueshëm, të qartë dhe të verifikueshëm, në mënyrë që vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të mos mbështetet vetëm në deklarime, por në prova objektive dhe të kontrollueshme.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se Njësia e Prokurimit, gjatë modifikimit të Dokumenteve të Tenderit, duhet të përcaktojë në mënyrë më të qartë dokumentacionin provues që do të shërbejë për vërtetimin e eksperiencës dhe mënyrën e verifikimit të tyre. Një përcaktim i tillë rrit transparencën e procedurës, siguron një metodologji vlerësimi të matshme dhe të verifikueshme, redukton hapësirën për vlerësime subjektive si dhe garanton respektimin e parimeve të prokurimit publik të sanksionuara sipas Nenit 2 të LPP.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6798, datë 13.06.2026 dhe me nr. protokolli 1878/2026 datë 15.06.2026 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukturës hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me pretendimet për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Autoriteti Kontraktor me anë të shkresës nr.2335/15 prot., datë 21.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1878/2 prot datë 23.07.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 132/2026 prot, datë 21.07.2026 ka vendosur pranimin e plotë të saj:
Konkretisht autoriteti kontraktor ka vendosur:

“[...]VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “MC NETWORKING” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
 - ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
- “2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, **KPP do të mbyllë shqyrtimin e ankesës së pranuar nga autoriteti kontraktor me numër ankimi elektronik nr. A/2026/6798, datë 13.06.2026 dhe me nr. protokoli 1878/2026 datë 15.06.2026 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK** për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.2. Lidhur me ankesën me numër ankimi elektronik nr. A/2026/6807, dhe me nr. 1886/2026 prot, datë 15.06.2026, e operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK me pretendimet për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2339/13 prot., datë 21.07.2026, protokolluar me tonën me nr. 1886/2 prot., datë 23.07.2026, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me vendimin nr. 131/2026 prot, datë 21.07.2025 ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, si më poshtë:
Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar:

“[...]VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “H O R I Z O N ” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”

III.2.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.2.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, **KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pjesën e pranuar të ankesës duke vijuar me shqyrtimin vetëm të pjesës së pa pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6807, dhe me nr. 1886/2026 prot, datë 15.06.2026, e operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK.**

III.3. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “H O R I Z O N” SHPK mbi

modifikimin e dokumentave të tenderit përcaktimeve në specifikimeve teknike, “Dukëshëm e qartazi Autoriteti Kontraktor është kujdesur që e gjithë pesha e vlerësimit teknik është përqendruar ekskluzivisht në vetëm kualifikimet e anëtarëve të stafit teknik (të përzgjedhura e të orientuara për OE të vecantë që i disponojnë q ëjanë të lidhur po me Prodhues të përzgjedhur paraprakisht), ndërkohë që nuk parashikohet asnjë pikëzim për sa më lart e përtej atyre si: përfshirjen e të gjithë kriterëve të vecanta në pikëzim, përllogaritjen e kostove të ciklit jetësor përfshirjen e specifikimeve teknike të produkteve objekt prokurimi zgjidhjen teknike të propozuar; metodologjinë e implementimit; performancën dhe disponueshmërinë e zgjidhjes; sigurinë e infrastrukturës; menaxhimin e riskut teknik; Në këto kushte: vlerësimi i ofertës nuk lidhet me cilësinë reale të zgjidhjes së propozuar, por kryesisht me certifikimet individuale dhe eksperiencat e deklaruara të disa anëtarëve të stafit teknik. një pjesë e konsiderueshme e pikëzimit mbështetet në numrin e projekteve në të cilat ekspertët DEKLAROJNË se kanë marrë pjesë, pa u parashikuar mekanizma objektivë dhe të matshëm për vlerësimin e kompleksitetit, ngjashmërisë, shkallës së vështirësisë apo rolit real teknik të secilit ekspert në këto projekte. metodologjia e parashikuar i jep peshë kryesisht numrit të projekteve të deklaruara, ndërkohë që: komisioni i vlerësimit nuk disponon kriterë të qarta dhe të verifikueshme për të matur në mënyrë objektive nivelin e kontributit teknik të ekspertit në secilin projekt, rëndësinë e projektit në raport me objektin e kësaj kontrate, apo shkallën e ngjashmërisë së tij me infrastrukturën që kërkohet të implementohet. Për rrjedhojë, vlerësimi: orientohet në OE të caktuar që plotësojnë thjesht e vetëm një numër të kufizuar kriteresh të cilët abuzivisht janë përzgjedhur për tu vlerësuar me pikë është i lidhur me Prodhues paraprakisht të përgjedhur (sic do detajohet në Ankesat e mëposhtme) rrezikon të reduktohet në një proces formal numërimi të projekteve dhe certifikimeve, pa mundësinë reale për të diferencuar eksperiencat që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës nga ato që, megjithëse të deklaruara, mund të mos kenë të njëjtën relevancë teknike apo kompleksitet. Ndërkohë qe qartazi objekti i kësaj procedure përfshin projektimin, furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin dhe migrimin e një infrastrukture komplekse datacenter, storage, SAN, virtualizimi, backup-i, NETWORKING, load balancing, firewall dhe sisteme të monitorimit të sigurisë, ku diferencimi real ndërmjet ofertave qëndron tek karakteristikat teknike të produkteve të propozuara, arkitektura e zgjidhjes, metodologjia e implementimit, performanca, disponueshmëria, siguria, migrimi dhe menaxhimi operacional i infrastrukturës. Megjithatë, asnjë prej këtyre elementëve nuk përbën objekt vlerësimi teknik në skemën e pikëzimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Për pasojë, metodologjia aktuale e vlerësimit krijon: , Avantazh të dukshëm për OE të përzgjedhur paraprakisht , Kufizim abuziv të konkurrencës të lirë e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit Mundësinë e vlerësimit subjektiv e avantazhues të ofertës ekonomike me vlerë më të lartë e që plotëson një numër të kufizuar kriteresh e kërkesash teknike - aspak duke u bazuar në të gjithë spektrin 360 gradë të eksperiencës, kapaciteteve, knoë-hoë, zgjidhjes teknike, qendrueshmërisë në kohë, etj, të OE potenciale të interesuar. , Disproporcion të dukshëm ndërmjet peshës së dhënë eksperiencës së dekluaruar të personelit dhe mungesës së plotë të vlerësimit të vetë zgjidhjes teknike që do të implementohet. Një qasje e tillë nuk garanton identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, nuk siguron një krahasim objektiv, proporcional dhe të verifikueshëm të ofertave dhe nuk krijon garanci se operatori i shpallur fitues do të jetë ai që ofron zgjidhjen teknike më të

përshtatshme dhe me vlerën më të lartë për Autoritetin Kontraktor. Kjo metodë vlerësimi gjykojmë se po përdoret për të përzgjedhur në mënyrë të orientuar e abuzive oferta të OE të paracaktuar, aspak bazuar në nivelin e cmimit, as të eksperiencës, cilësisë e specifikimeve të produkteve të ofruara! Kërkesa 1: Për sa më sipër, duke konsideruar se kriteret aktuale të vlerësimit nuk reflektojnë kompleksitetin teknik të objektit të kontratës dhe se një pjesë e specifikimeve teknike rezultojnë kufizuese dhe jo plotësisht të lidhura me nevojën funksionale të Autoritetit Kontraktor, kërkojmë rishikimin dhe përditësimin e dokumenteve të tenderit si vijon:

1. Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit dhe të shpërndarjes së pikëve, me qëllim që vlerësimi teknik të mos mbështetet ekskluzivisht në kualifikimet dhe eksperiencat e stafit, por të përfshijë edhe elementë që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e zgjidhjes së propozuar, arkitekturën teknike, metodologjinë e implementimit, sigurinë, performancën dhe disponueshmërinë e infrastrukturës që do të implementohet.
2. Rishikimin e kriterëve të pikëzimit të të gjithë kriterëve të vecanta dhe specifikimeve teknike (sipas Udhërrëfyesit), përfshirë ato të stafit teknik, duke përcaktuar në mënyrë të qartë dhe objektive tipologjinë e projekteve që konsiderohen të ngjashme me objektin e kontratës, specifikimet e produktit, etj, si dhe metodologjinë e vlerësimit të tyre, në mënyrë që pikëzimi të mos bazohet vetëm në numrin e projekteve të deklaruara, por edhe në relevancën, kompleksitetin, por dhe në kapacitete të tjera të OE (referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit) dhe lidhjen e tyre me objektin konkret të prokurimit.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1. Në pikën 4.4/A “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “PROCEDURA” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri i vlerësimit të ofertave të paraqitura, si më poshtë vijon::

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht me e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rendesise:

1. Çmimi 60 pike
2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. 0 – 40 pike

Argumentimi i Kriterëve të Pikezuara dhe Menyra e Llogaritjes së Pikeve:

1.Çmimi: 60 pike

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Piket për këto kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

$Pk1$ – Piket e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} – Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 – Piket maksimale qe i jepen kriterit qe vleresohet

Ok1 – Treguesi i ofertes per kriterin qe vleresohet

Argumentim: Kriteri i çmimit është përfshirë në dokumentet e tenderit si një nga elementët kryesorë të vlerësimit të ofertave, në përputhje me nenin 87 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të vlerësojë ofertat mbi bazën e ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto. Përcaktimi i çmimit me 60 pikë është bërë për të garantuar efikasitetin e përdorimit të fondeve publike, duke balancuar koston me cilësinë e elementëve të tjerë që janë përfshirë në vlerësim. Vlerësimi për këtë kriter është bërë në mënyrë proporcionale sipas formulës së përcaktuar në DST, duke siguruar trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik.

Kualifikimi dhe kompetencat profesionale te stafit teknik. 0 – 40 pike

Argumentimi: Vlerësimi ne pike per kualifikimin profesional dhe pervojen e stafit teknik eshte vendosur per te siguruar nje diferencim real te cilesise ne nje projekt qe perfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe mirembajtjen e nje infrastrukture hardware dhe rrjeti me nivel te larte kompleksiteti. Projekti perfshin arkitekture 2-site me Stretched Cluster 16 servere blade, 2 storage FC, 4 SAN Sëitch, 4 firewall qendrore, 10 firewall degesh, sëitch datacenter dhe degesh, load balancer me WAF dhe platforme analize ngjarjesh sigurie.

Pervoja profesionale e stafit perben nje tregues te drejtperdrejte te cilesise se realizimit te kontrates, stabilitetit operacional dhe menaxhimit te riskut teknik gjate fazave te implementimit dhe mirembajtjes 24-mujore.

Nga stafi i kerkuar ne Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, pika 2.3.4, NJP gjykon te vendose si pjese e vlerësimit me pike si me poshte:

Detajimi i pikezimit eshte si me poshte:

2.1 Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si menaxher projekti PMP nga PMI, ose Prince 2). 0 – 5 pike, e ndare:

Ne projekte te tilla, roli i Projekt Menaxherit eshte kyç per menaxhimin sa me te mire ne kohe dhe ne cilesi te projektit. Ky punonjes, i certifikuar per kete qellim, do te kete kompetencat per te ndjekur projektin, per te bashkerenduar punen, per te ndervepruar me AK ne lidhje me nevojat dhe

problematikat e zbatimit te kontrates. Eksperienca e ketij punonjesi eshte nje element kyç qe ndikon ne mbarevajtjen dhe zhvillimin e projektit me cilesi.

Eksperienca ne pune si projekt menaxher ne vite 0 – 3 pike

Argumentim: Eksperienca ne vite eshte nje element i cili tregon aftesi dhe kompetenca ne pune.

Pervoja ne vite eshte tregues i drejtperdrejte i stabilitetit profesional, aftesise per te menaxhuar cikle te plota projekti dhe per te perballuar situata komplekse teknike dhe organizative.

Kriteri vleresohet ne menyre proporcionale: projekt menaxheri me me shume eksperience ne vite vleresohet me piket maksimale (3 pike) dhe projekt menaxheret e tjere sipas formule.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vleresimit do te mbeshtetet ne dokumentet e dorezuara nga operatori ekonomik. Piket do te jepen ne menyre proporcionale sipas numrit te kualifikimeve te vlefshme te konstatuara. AK mund te kryeje verifikime.

Dokumentacioni per verifikim: Per te vertetuar eksperiencen ne pune dhe projektet e zbatuara duhet te paraqitet CV e detajuar ku te vertetohet sa me siper.

Vleresimi do te behet si me poshte:

Piket per kete kriter perlllogariten sipas formule:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 – Piket e kriterit qe vleresohet

Vmink1 – Vlera me e ulet e ofruar per kriterin qe po vleresohet

Pmaxk1 – Piket maksimale qe i jepen kriterit qe vleresohet

Ok1 – Treguesi i ofertes per kriterin qe vleresohet

Eksperienca si projekt menaxher ne projekte ne numer 0 – 2 pike

Argumentim: Numri i projekteve ne te cilat PM ka marre pjese eshte tregues i rritjes se aftesive dhe kompetencave ne pune. Numri i projekteve te menaxhuara perben tregues konkret te pervojes praktike, duke rritur aftesine per planifikim efektiv, kontroll te afateve dhe menaxhim te riskut.”

III.3.2. Në shtojcën 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë në stafin e tyre, punonjësit, si më poshtë vijon:

2.3.4. Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP nga PMI, ose Prince 2;

b) Minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, ITIL të leshuar nga institucionet zyrtare nderkombetare si Axelos ose PeopleCert

- c) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin profesional ose me te avancuar per pajisjet server, nga prodhuesi i pajisjeve server te ofertuar
- d) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin profesional ose me te avancuar për pajisjet Storage, nga prodhuesi i pajisjeve storage te ofertuar;
- e) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për implementim, konfigurim, administrim te sistemeve te operimi Microsoft Eëindoës Server ose Linux ose Unix nga prodhuesit e ketyre platformave ;
- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për platformën e ruajtjes dhe vendosjes së të dhënave (backup dhe restore) nga prodhuesi;
- g) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar per routing dhe sëitching ne nivel profesional ose me te avancuar, për pajisjet e tipit sëitch, nga prodhuesi i pajisjeve sëitch te ofertuar;
- h) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel profesional ose me te avancuar për konfigurime te pajisjeve të sigurisë së rrjetit të tipit firewall, nga prodhuesi i pajisjeve firewall te ofertuar;
- i) Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për analizën proaktive të kërcënimeve dhe monitorimin e sigurisë si dhe per zbatimin e praktikave të sigurisë kibernetike, menaxhimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e infrastrukturës IT.

**Shënim: Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.*

**Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).*

**Shënim: Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, ne permbushje te nenit 82, te Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar dhe nenit 26 te VKM Nr. 285/2021, i ndryshuar.*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”

parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.7. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën; d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë

përsipër të realizojë.”.

III.3.8. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: 1. *Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve: a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si: i. kostot që lidhen me blerjen; ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera; iii. kostot e mirëmbajtjes; iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim. b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik. 2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave. Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme: a) bazohet mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese. b) nëse nuk është krijuar për t’u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë; c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara; ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.*

III.3.9. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosën që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve

mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si: 1. Çmimi 60 pike, 2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. 0 – 40 pike.

III.3.10. Nga shqyrtimi i Shtojcës 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit dhe konkretisht i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të këtyre dokumentave, Komisioni gjykon të trajtoj pjesën e papranuar të pretendimit të ankimuesit. Konkretisht konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre profesionistët e përcaktuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi, ku në fazën e ofertimit për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë e dokumentave të tenderit, ndërkohë që ofertuesit duhet të paraqesin lidhur me disponimin e stafit dokumentacioni për verifikim: *Per te vertetuar eksperiencen ne pune duhet te paraqitet CV e detajuar ku te vertetohet sa me siper. AK mund te kryeje verifikime..*”, ku referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar ligjërisht vendosjen e këtij kriteri duke u bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ndërkohë që teknikisht ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri, duke argumentuar si në vijim: *“Argumentimi: Vleresimi në pikë për kualifikimin profesional dhe pervojen e stafit teknik eshte vendosur per te siguruar nje diferencim real te cilesise ne nje projekt qe perfshin furnizimin,instalimin, konfigurimin dhe mirembajtjen e nje infrastrukture hardware dhe rrjeti me nivel te larte kompleksiteti. Projekti perfshin arkitekture 2-site me Stretched Cluster 16 servere blade, 2 storage FC, 4 SAN Sëitch, 4 firewall qendrore, 10 firewall degesh, sëitch datacenter dhe degesh, load balancer me WAF dhe platforme analize ngjarjesh sigurie.Pervoja profesionale e stafit perben nje tregues te drejtperdrejte te cilesise se realizimit te kontrates, stabilitetit operacional dhe menaxhimit te riskut teknik gjate fazave te implementimit dhe mirembajtjes 24-mujore.”*. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 4.4/A “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “PROCEDURA” të dokumentave të tenderit ka përcaktuar kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, duke përcaktuar si kriter vlerësimi metodën “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto”, ku një nga kriteret e vlerësimit për ofertat e dorëzuara dhe të kualifikuara (që plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 9 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit është përvoja dhe kualifikimi i tyre (pjesë e stafit të operatorit ekonomik ofertues), ndërkohë që referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi për këtë kriter do të bëhet duke paraqitur CV e detjaura mbi të cilat autoriteti kontraktor do të kryej verifikimet e mbi vërtetësin e tyre. Lidhur me pretendimin e operatorit

ekonomik ankimues “HORIZON” SHPK të parashtruara në pikën III.3. të këtij vendimi, KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me vendimin “Vendim K.SH.A. 131/2026” ka arsyetuar si në vijim: “Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “4 S” shpk ku shprehimisht përcaktohet se: “KSHA, konstaton se shpërndarja e pikëve është e lidhur ngushtë me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve teknike, kontrata nuk konsiston vetëm në furnizimin e pajisjeve hardware, por përfshin një projekt të integruar që përbëhet nga projektimi, instalimi, konfigurimi, implementimi, migrimi, testimi dhe mirëmbajtja e një infrastrukture kritike të teknologjisë së informacionit. Projekti përfshin, ndër të tjera, implementimin e një arkitekture me dy site (Stretched Cluster), serverë blade, sisteme enterprise storage, rrjet SAN, pajisje të avancuara të rrjetit, firewall, load balancer me funksionalitete WAF, platformë virtualizimi dhe mirëmbajtje shumëvjeçare të të gjithë infrastrukturës. Në këto kushte, realizimi me sukses i kontratës nuk varet vetëm nga karakteristikat teknike të pajisjeve të ofertuara, por edhe nga aftësia profesionale e personelit që do të kryejë instalimin, konfigurimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Për rrjedhojë, vlerësimi me pikë i eksperiencës dhe kompetencave profesionale të stafit teknik përbën një kriter objektiv, proporcional dhe të lidhur drejtpërdrejtë me cilësinë e ekzekutimit të kontratës, duke synuar përzgjedhjen e Operatorit ekonomik që ofron garanci më të larta për realizimin e saj në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor....Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se Autoriteti Kontraktor ka ushtruar diskrecionin e tij brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik, duke argumentuar në mënyrë të mjaftueshme lidhjen ndërmjet metodologjisë së vlerësimit, shpërndarjes së pikëve dhe specifikimeve teknike të objektit të prokurimit. Për rrjedhojë, metodologjia e përzgjedhur rezulton të jetë e ligjshme, e arsyeshme dhe proporcionale me natyrën, kompleksitetin si dhe rëndësinë e kontratës objekt prokurimi. Gjithashtu, parimi i ushtrimit të diskrecionit në vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor për përzgjedhjen e kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese, i nënshtrohet edhe rregullimeve të Nenit 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”, të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se : “Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe; ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”. Ndërsa në lidhje me pretendimin e ankimuesit se: “...Komisioni i Vlerësimit nuk disponon kriterë të qarta dhe të verifikueshme për të matur në mënyrë objektive nivelin e kontributit teknik të ekspertit në secilin projekt, rëndësinë e projektit në raport me objektin e kësaj kontrate, apo shkallën e ngjashmërisë së tij me infrastrukturën që kërkohet të implementohet...”, KSHA gjykon se: Nga shqyrtimi i Dokumenteve të Tenderit, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka parashikuar që, për efekt të vlerësimit të eksperiencës së stafit teknik, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin CV- të e punonjësve, të cilat duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi eksperiencën profesionale, si dhe mbi projektet ose kontratat e ngjashme të realizuara, duke përfshirë objektin e kontratës, përshkrimin teknik të saj dhe të paktën një kontakt reference për secilin projekt ose kontratë..... duke argumentuar ndarjen e

pikëzimit në vetëm këto 2 shtylla, sikundër operatorit ekonomik i cili nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë shteruese dhe ligjore shtimin e shtyllave apo elementëve kryesor të cilët do ti nënshtrohen pikëzimit të dokumentave të tenderit dhe akoma më tej pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në vetvete përbën shtim kriteri, ku KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor ka gjykuar se kriteret e përcaktuara janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës me sukses, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Horizon” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me numër reference: Nr. REF-88710-06-03-2026, me objekt: “Përmisim i infrastrukturës hardware për sistemet doganore dhe rrjetet fizike”, me fond limit 387,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 06-07-2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “HORIZON” ShPK për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “HORIZON” ShPK për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.
4. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” ShPK.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kalimin në buxhet të shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “HORIZON” ShPK.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

